



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	19.05.2021
<b>Referenc-ë:</b>	07-353/04-82205/21
<b>Për/ Za/ To:</b>	“Advors Agency”
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-82205/21 nga “Advors Agency” me përfaqësuese Kosovare Maliqi në bashkëpunim me “Jaffa Champion” me të cilën kërkohet që me datë 26 dhe 27 Qershor 2021 nga ora 11:00 deri në 13:00 nga të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike, sheshi “Zahir Pajaziti”. Qëllimi i këtij mini eventit është argëtimi i fëmijëve duke vendosur një skenë në të cilën do të përformojnë palaçot si dhe do të ketë muzikë dhe skeçe të përgatitura nga fëmijët.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Zahir Pajaziti” me datë 26 dhe 27 Qershor 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.